

INFORMACIONE
PER PRINDER

Pickimi i rriqrës



Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni me pagesë për këshillime: 0900 266 71 1

Si të sillem unë, kur unë të fëmija im kam gjetur një apo më tepër rriqra?

Rriqra/t do të duhej të hiqen sa më shpejtë që është e mundur me një pincetë. Rriqra mundësisht duhet të kapet direkt mbi lëkurë dhe të tërhiqet drejtë prapthi prej kanalit të pickimit. Nëse nuk keni pincetë me vete, rriqrën mund të e kapni me thonj të gishtit të madh dhe atij tregues dhe të e nxirrni. Vendi i pickimit pastaj mund të dezinfektohet me mjete të zakonshme dezinfektimi.

Kujdes: Duke e nxjerrë rriqrën, të keni kujdes, që atë të e dridhni sa më pak që është e mundur. Gjithashtu nuk guxonin të derdhni vaj mbi rriqër! Nëse gjatë nxjerrjes së rriqrës në lëkurë mbetet koka apo ndonjë gjymtyrë, nuk është e nevojshme të i nxirrni ato gjithsesi. Gjëja kryesore është, që të hiqet trupi e veçmas organet e tretjes së rriqrës. Rriqrën nuk keni nevojë të e depononi, pasi që nuk do të bëhet ekzaminimi i sajë.

Çka duhet të kam unë parasysh pas pickimit të rriqrës dhe kur do të duhej të lajmërohem te mjeku?

- Po që se në 3-32 ditët e ardhshme pas pickimit të rriqrës paraqiten skuqje që zgjerohen ngadalë, pa dhimbje, me formë unaze rreth vendit të pickimit, dhe mundësisht edhe në pjesë tjera të trupit, atëherë duhet të vizitohet mjeku.
- Paraqitja e etheve apo dhimbje të mëdha koke 7-14 ditë pas pickimit të rriqrës.
- Paraqitja e ënjtjeve të paqarta të njejeve, veçmas të izoluara në gju apo njeje të shputës (mund të paraqitet me javë e muaj pas pickimit të rriqrës).
- Paraqitja e një paralize të njëanshme të fytyrës (mund të paraqitet 3-10 javë pas pickimit të rriqrës).